

ERIKETA KAMBO

**MËSUESIT SHQIPTARË DHE RIORGANIZIMI I SHKOLLËS
(1960-1965)**

Ndryshimet që shkolla shqiptare përjetoj në fillimin e viteve '60, me zbatimin e reformës për riorganizimin e arsimit, ishin përcaktuese edhe për ecurinë e problemeve të kuadrit. E përbashkët për të gjithë periudhën mbetet ndjekja e të njëjtave politika të mëparshme, që nuk gjeneruan përmbysje. Bëhet fjalë për zhvillime brenda të njëjtit sistem politik, të diktuar nga nevoja e konsolidimit të tij.

Në vijimësi, PPSH ndërmori masa të shumta për sigurimin e një numri të mjaftueshëm mësuesish të kualifikuar dhe të përgatitur profesionalisht dhe sidomos, të formësuar si “misionarë” të edukimit komunist të gjeneratave të reja. Këto mbetën dy nga drejtimet themelore të politikës zyrtare shqiptare, deri në rënien e plotë të sistemit në vitet '90. Parë nga ky këndvështrim duket i drejtë konstatimi i John J.Thomas dhe studiuesve të tjerë perëndimorë në fokusin e interesave të cilëve janë probleme të sistemit të edukimit në Shqipëri, që mësuesi shihej nga udhëheqja komuniste e vendit “si faktor i rëndësishëm për ndikimin dhe edukimin e nxënësve ... përgjegjës për zhvillimin e procesit mësimor dhe futjen në këtë proces të ideologjisë komuniste”¹. Analiza e këtij procesi në caqet e një artikulli, ku mundësitë për të rrokur gjithë problematikën janë të limituara, na detyron të fokusohemi vetëm në trajtimin e zhvillimeve më kryesore në fushën e përgatitjes dhe atë të kualifikimit të mësuesve.

*
* *
*

1. Përgatitja dhe sigurimi i kuadrit për reformën

Problemi i personelit mësimor-edukativ i shfaqur në aspektet e tij themelore, si: shkalla e arsimit, kualifikimi, profilizimi, origjina shoqërore, raportet fshat-qytet, kuadër i vjetër dhe i ri, predispozicioni për t'u përfshirë në çështjet e shkollës dhe më gjerë në ato të shoqërisë, kushtëzimin në një farë mënyre vetë ecurinë e reformës.

¹ John J. Thomas, *Education For Communism*, Staford University-Stanford, California: “Hoover Institution Press”, 1969, f. 106-107.

Në vitin 1960 kadri arsimor arriti në 10.874 mësues, prej të cilëve rreth 4026 ishin mësues të rinj, të diplomuar respektivisht 1816 nëpërmjet shkollave pedagogjike, 384 në institutet pedagogjike dyvjeçare, 295 në fakultetet e universitetit dhe 1000 nëpërmjet sistemit të korrespondencës e kurseve². Në pamje të parë zhvillimet sasiore ishin pozitive në raport me pikën e nisjes, ndonëse nevojat për kadro mbeteshin të konsiderueshme.

E gjithë pesha e ndryshimeve do të binte mbi supet e kadrit ekzistues, i cili si nga këndvështrimi sasior, ashtu edhe niveli kulturor e profesional, nuk qëndronte në parametrat që kërkonte ndërmarrja e një reforme të re. Në të gjitha kategoritë e sistemit arsimor, treguesit realë ishin larg deklarimeve të strukturave shtetërore e atyre partiake që, niveli i kualifikimit në vitin 1960 do të ishte respektivisht 60 për qind në arsimin fillor, 40 për qind në atë shtatëvjeçar dhe 80 për qind në arsimin e mesëm³.

Për nevojat e zgjerimit deri në këtë periudhë ishin tërhequr një masë e tërë mësuesish pa arsimin e duhur. Të rinj dhe të reja që kishin përfunduar shkollat shtatëvjeçare, u përfshinë në kurse 3-5 mujore dhe pas përfundimit të tyre, mbushën radhët e mësuesve të shkollave fillore. Vetëm 23 për qind e arsimtarëve të shkollave 7-vjeçare dhe 15 për qind e atyre që jepnin lëndët e shkencave kishin shkollën e duhur të kualifikimit. Treguesit në arsimin e mesëm ishin disi më të larta, por gjithsesi nuk kalonin mbi 60 për qind⁴.

Riorganizimi i shkollës shtronte kërkesën e përgatitjes së një personeli arsimor të mjaftueshëm dhe njëherë të aftë për të realizuar thelbin e saj, lidhjen e mësimin me prodhimin, edukimin e të rinjve për punë dhe nëpërmjet punës. Në analizën që i bënte këtij procesi ministri i atëhershëm i Arsimit, Manush Myftiu, do të konfirmonte se edhe më tej, politika zyrtare do të orientohej drejt intensifikimit të masave për përgatitjen dhe kualifikimin e mësuesve, ngritjen nga pikëpamja “e kulturës së përgjithshme dhe politeknike”, njohjen e tyre “me prodhimin dhe me metodat e reja që kërkonte riorganizimi i shkollës” etj.⁵

Në fokusin e kërkesave të kohës pyetja që shtrohej ishte se sa mundësi reale kishte sistemi ekzistues i përgatitjes dhe kualifikimit të përballonte ndryshimet, cilat do të ishin problemet që duhej të kapërcente për të mos u bërë pengesë për reformën, sa do të ishte shkalla e zgjidhjes etj. Shteti ishte thellësisht i interesuar për ecurinë e një procesi që do t’i kontribuonte forcimit të karakterit socialist të sistemit arsimor. Në këtë kontekst ai ndërmori nisma të shumta të vlerësuara si “radikale” dhe urgjente, që pavarësisht ngjyimeve të

² Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi i Këshillit të Ministrave, Nr.490, viti 1964, dos. 1143, fl.8.

³ Po aty, Fondi i Ministrisë së Arsimit, nr. 511, viti 1959, dos.11, fl. 11-14.

⁴ Po aty, Fondi 490, viti 1964, dos. 1143, fl. 1-8.

⁵ *Arsimi Popullor*, viti 1960, nr.7, f.9, Fjala e Manush Myftiut “Mbi riorganizimin e sistemit arsimor”.

reja me të cilat u paraqitën, ishin vazhdim i politikave të mëparshme. Analiza e dokumentacionit të periudhës mbështet argumentin se, në zgjidhjen e çështjeve të personelit mësimor-edukativ u operua me po të njëjtat rrugë e forma të aplikuara edhe më parë, ndonëse duhet pranuar se u tentua për rritjen e efikasitetit të tyre.

Kur flitej për përgatitjen e kuadrit në kuptimin sasior, nënkuptoheshin dy aspekte të problemit. *Së pari*, sigurimi i elementeve të mjaftueshëm për shkollat dhe institutet dhe *së dyti*, numri i të diplomuarve që duhej të jepte i gjithë sistemi i përgatitjes dhe kualifikimit të mësuesve. Ndonëse pjesa më e madhe e nxënësve dhe e studentëve tërhiqej nëpërmjet një sistemi të favorshëm bursash, për shumë arsye objektive e subjektive që do t'i japim përmbledhtazi, arsimit pedagogjik mbetej problematik.

Fakti që destinacioni i këtyre shkollave ishte përgatitja e mësuesve që në masën kryesore do të punonin në fshat, i bënte pak të interesuar elementët nga qyteti, duke ngushtuar rrethin e atyre që dëshironin të bëheshin mësues. Rajonet më pak të zhvilluara, sidomos ato të veriut, nga të cilat mund të siguroheshin elementë të mjaftueshëm, vuanin mungesën e nxënësve që kishin përfunduar arsimin shtatëvjeçar apo atë të mesëm. Jo pak ndikonte mentaliteti i prindërve, për të mos dërguar vajzat në shkollë. Sipas të dhënave të vitit 1960 rrethe të tilla, si p.sh. Rrësheni nga 17 nxënës të planifikuar për në shkollat pedagogjike nuk kish mundur të siguronte asnjë, Pogradeci nga 21 vetëm 4, Librazhdi nga 8 vetëm 1 dhe Tropoja nga 13 të planifikuar 3 nxënës etj.⁶

Mbetjet në klasë dhe largimet gjatë viteve, ndonëse u tentua të kompensoheshin me shtimin e numrit të nxënësve të rinj, përbënin një tjetër dukuri negative. Rezultatet e shkollave pedagogjike ishin më të ulëta në raport me kategoritë e tjera arsimore. Jo më tepër se 66,3 për qind e të regjistruarve arrinin të fitonin klasën⁷. Vështirësitë në gjetjen e elementeve ishin karakteristike edhe për kategoritë më të larta. Institutet pedagogjike, sidomos ato dyvjeçare konsideroheshin si shkolla “gjysmake” dhe realisht nuk mund të krahasoheshin me institutet e tjera të larta, si nga vështirësia e punës që ofronin pas diplomimit, ashtu edhe e trajtimit financiar.

Për t’iu përgjigjur kërkesave të shkollës së riorganizuar, para së gjithash i gjithë sistemi i përgatitjes dhe kualifikimit duhej të zhvillohej dhe konsolidohej. Nevojat për mësues vijonin të ishin të mëdha. Reforma presupozonte një zgjerim më të shpejtë të të gjitha hallkave të sistemit arsimor dhe në mënyrë specifike të atij shtatëvjeçar dhe të mesëm. Për rrjedhojë, ashtu si edhe pritej, kërkesat për personel mësimor-edukativ erdhën në rritje.

Sipas një studimi paraprak parashikimi për futjen e 37.000 nxënësve në shkollën fillore 15.000 në atë shtatëvjeçare dhe 2000 nxënësish në arsimin e

⁶ AQSh, Fondi 511, viti 1959, dos. 30, fl. 49-51.

⁷ Po aty, fl. 50-51.

mesëm, do të mund të përballohej me personel mësimor diku aty nga mesi i viteve 60-të, nëpërmjet rritjes së kontigjentit të nxënësve të rinj në shkollat pedagogjike dhe institutet pedagogjike dyvjeçare⁸. Këto të fundit duhej të tërhiqnin të paktën 21.000 nxënës dhe studentë, për të plotësuar nevojat minimale për mësues. Në institutet pedagogjike dyvjeçare dhe fakultetet e Universitetit duhej të hynin të paktën 4000 studentë të rinj, prej të cilëve 3000 vetëm në degën e shkencave të natyrës⁹.

Nisur nga gjendja reale, duket e arsyeshme të mendohet se nevojat e mëdha të viteve të para nuk mund të përballoheshin tërësisht me mësues të përgatitur në shkollat pedagogjike. Strukturat shtetërore dhe ato partiake ndonëse nën zë, detyrohen ta pranojnë faktin që do të vazhdonin të ndiqeshin politika që stimulonin vazhdimësinë e formave të përshpejtuara. Në një material konfidencial dërguar Komiteteve të Partisë të rretheve, nga Drejtoria e Arsimit e Kulturës pranë KQ të PPSH në vjeshtën e vitit 1960, do të pohohej se: “Edhe gjatë pesëvjeçarit të III-të nuk ka asnjë mundësi që i gjithë kuadri i arsimit të përgatitet në rrugë normale nëpërmjet sistemit të arsimit pedagogjik” dhe se përveç kurseve 5-6 mujore për përgatitjen e arsimtarëve të shkollave fillore dhe kopshteve të fëmijëve, do të duhej të hapeshin “kurse të shpejta për mësues të shkollave shtatëvjeçare” etj.¹⁰

Kjo nënkuptonte që një pjesë e mirë e kërkesave do të mund të plotësohej nëpërmjet formave të përshpejtuara të përcaktuara si “të përkohshme”, por që ecuria e mëtejshme e procesit provoi se deri në mesin e viteve 60-të ato mbetën të rëndësishme. Strukturat arsimore vazhduan t’i përdorin si burime alternative. Në kurset 1-2 vjeçare pranë shkollave pedagogjike, shkollën dyvjeçare të punëtorëve dhe atë të kualifikimit në Elbasan u tërhoqën kryesisht elemente që kishin përfunduar arsimin shtatëvjeçar apo të mesëm. Pas provimeve të specialitetit dhe praktikës në shkolla atyre u njihej arsimit i mesëm pedagogjik dhe e drejta e ushtrimit të profesionit¹¹.

Veçanërisht i vështirë ishte sigurimi i mësuesve për lëndët e shkencave që zinin një vend të rëndësishëm në arsimin e përgjithshëm dhe atë profesional. Humbjet e studentëve gjatë viteve ishin të konsiderueshme. Preferenca të pakta për shkak të vështirësive vëreheshin për këto fakultete, sidomos në institutet pedagogjike dyvjeçare. Në rast se i referohemi të dhënave të vitit shkollor 1960-1961, konstatohet se nga 365 studentë të regjistruar vetëm 232 ose 64 për qind vijnë në mësimet rregullisht dhe në fakultetin e matematikë-fizikës më pak se gjysma e tyre¹².

⁸ *Po aty*, Fondi 511, viti 1961, dos. 116, fl.111.

⁹ *Po aty*.

¹⁰ *Po aty*, Fondi 14, viti 1960, dos. 94, fl.4-5.

¹¹ *Po aty*, Fondi 511, viti 1960, dos. 101, fl.2.

¹² *Po aty*, dos. 114, fl. 40-42.

Për të zbutur disi problemin, me një vendim të Këshillit të Ministrave nga viti shkollor 1960-1961 filloi funksionimi i shkollës dyvjeçare të punëtorëve të arsimit. Në të pranohen mësues të shkollave fillore, pa arsimin e duhur por me përvojë pune 2-3 vjeçare. Më tej atyre u njihet e drejta e vazhdimit të studimeve në institutet pedagogjike dyvjeçare. Në masën kryesore kjo kategori u destinua, për vijimësinë e shkollës në degët e shkencave të natyrës. Për të stimuluar studentët vendimi parashikonte akordimin e bursës së plotë, pavarësisht gjendjes ekonomike. Pjesa e tij ishte vendosja e një shpërblimi suplementar për mësuesit e shkencave me arsimin përkatës¹³.

Hedhja e bazave të një sistemi pak a shumë të plotë për përgatitjen dhe kualifikimin e mësuesve si dhe plotësimi i kuadrit ligjor do të krijonin hapësira të mjaftueshme në këtë fushë. Problemi qëndronte se sa dhe si, do të shfrytëzoheshin kapacitetet e tij. Gjykuar nga ky këndvështrim, një element i rëndësishëm mbetej edhe për këtë periudhë sigurimi në kohë i “numrit të nxënësve, studentëve dhe kursantëve”¹⁴. Mangësitë në këtë drejtim kushtëzonin jo vetëm ritmet e zgjerimit të arsimit, sidomos në hallkat e tij bazë, por vetë realizimin e reformës. Vështirësitë ishin prezente dhe nuk mund të anashkaloheshin. Brenda një periudhe dyvjeçare me gjithë përpjekjet numri i përgjithshëm i nxënësve dhe studentëve të rinj në gjithë sistemin e arsimit pedagogjik ishte i pamjaftueshëm.

Shkollat pedagogjike katërvjeçare, ajo e kualifikimit në Elbasan, si dhe fakultetet e Universitetit, njohën tregues relativisht më të mirë. Në sigurimin e elementeve, mangësitë ishin më të mëdha në kurset dhe për rrethe të tilla si Puka, Kukësi, Librazhdi, Tropoja, Pogradeci etj. Kurset afatgjata 8 dhe 18 mujore realizuan vetëm 85 për qind të planit të vitit 1961 dhe në vitin pasardhës vetëm 48,5 përqind të tij. Institutet pedagogjike dyvjeçare ku u tërhoqën vetëm 70 për qind e studentëve krijuan një mosrealizim prej 300 studentësh që çoi si do të vërehej me shqetësim në një dokument të periudhës, në krijimin e deficienteve “në përgatitjen e kuadrit arsimor dhe sigurimin e arsimit të tij përkatës”¹⁵.

Pasoja negative në plotësimin e nevojave për kuadro linte edhe mbarëvajtja e formave. Rezultatet e kurseve por edhe të shkollave të rregullta ishin të ulëta. “Po të ecet me një ritëm të tillë, në përgatitjen e mësuesve të ardhshëm, do të pohohej në një informacion të Ministrisë së Arsimit, rrezikohet seriozisht sigurimi i kuadrit të nevojshëm”. Shqetësimi bazohej në rezultatet e vitit 1961-1962 të shkollave pedagogjike, që ishin burim kryesor i përgatitjes së

¹³ *Gazeta Zyrtare*, viti 1960, n. 13, f. 435. Vendimi i K. Ministrave nr. 449, dt. 21.10.1960, “Mbi disa masa për përgatitjen e shpejtë të kuadrit arsimor të lëndëve të shkencave”.

¹⁴ *Arsimi Popullor*, viti 1961, nr.1, f.26. Artikulli K. Ylli “Puna me kuadrin”.

¹⁵ *AQSh*, Fondi 14, viti 1962, dos. 142, fl. 1-2.

kuadrit për arsimin fillor, të cilat i përfunduan jo më tepër se 56,1 për qind e nxënësve¹⁶.

Fakti që tashmë ishin krijuar boshllëqe nga defektet e formave të arsimit pedagogjik fillon e pranohet edhe nga organet shtetërore. Sekretari i KQ të PPSH në janarin e vitit 1962, detyrohet të bëjë objekt të analizës mangësitë e vërejtura në këtë fushë duke kërkuar nga të gjitha strukturat shtetërore e ato partiake rritjen e kujdesit “për realizimin dhe tejkalimin e planeve në gjithë rritjen e arsimit pedagogjik”, dhe sigurimin e burimeve të reja “për përgatitjen e kuadrit, sidomos për shkollat e ardhshme tërëvjeçare dhe në mënyrë të veçantë, për ato të fshatit”¹⁷.

Përpos vështirësive që përfaqësonte në vetvete konsolidimi i gjithë sistemit të arsimit pedagogjik, duket se efekt negativ ushtronte edhe kanalizimi i problemit brenda linjave të një planifikimi rigoroz, diskutimi i të cilit mbetej tabu. Pjesë e tij ishte p.sh. parashikimi që në Universitet do të përgatiteshin 80 për qind e kontigjentit që do të hynte në vitin e parë dhe, 90 për qind e atyre të instituteve dyvjeçare kur rezultatet e deriatëhershme për Universitetin ishin vetëm 69 për qind dhe, instituteve dyvjeçare rreth 45 për qind¹⁸.

Nën trysinë e organeve më të larta, strukturat e bazës ndërtuan plane të sforcuara dhe të pabazuara si duhej. E përballur me këtë fenomen, Drejtoria e Arsim Kulturës pranë KQ të PPSH në një farë mënyre e pranon situatën, duke e shkarkuar përgjegjësinë gjithnjë mbi këto të fundit për planifikime me të meta. “Planifikimi vërtet është bërë në bazë të nevojave, do të evidencohej në një udhëzim të majit 1962, por format dhe rrugët që janë përdorur për të siguruar kuadrin arsimor dhe sidomos arsimin përkatës të tij, në mjaft raste janë bazuar më shumë në dëshirat se sa, në mundësitë reale”¹⁹. Gjithnjë sipas strukturave të larta partiake “objektivat ishin të qarta”, por meritonin të gjithë kujdesin për përmbushjen e tyre, se ato ishin dhe mbeteshin baza e gjithë veprimtarisë në këtë fushë etj.

Në korrikun e vitit 1962 u thirr një plenum i veçantë i KQ të PPSH, i cili analizoi problemet e mprehta në fushën e përgatitjes së kuadrit për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe kulturës së vendit. Pjesë e vendimeve ishte forcimi i masave të deriatëhershme për sigurimin e kuadrit të nevojshëm për zgjerimin e mëtejshëm të arsimit sidomos të atij 8-vjeçar. Kjo do të mund të realizohej nëpërmjet organizimit të shkollave të mesme të kulturës së

¹⁶ *Po aty*.

¹⁷ *Po aty*, Fondi 14, dos. 17, fl. 78-80, Vendimi i Sekretariatit të KQ të PPSH nr. 38, dt. 20.01.1962 “Mbi disa çështje të kuadrit arsimor”.

¹⁸ *Po aty*, dos. 20, fl. 4-5.

¹⁹ *Po aty*.

përgjithshme me afate trevjeçare, që do të ndiqeshin nga nxënësit e fshatit dhe që më tej do të furnizonin institutet pedagogjike dyvjeçare etj.²⁰

Mbi këtë bazë planet e përgatitjes dhe kualifikimit të mësuesve pësuan ndryshime dhe retushime të pjesshme. Shkollat pedagogjike rritën numrin e nxënësve, duke tërhequr elementë nga fshatrat e afërta dhe qytetet ku ndodheshin. Në të njëjtën mënyrë u mbushën edhe boshllëqet e krijuara në klasat e ndërmjetme. Më vonë, pranimi i nxënësve të jashtëm nga qyteti u kufizua. “Ne duhet të luftojmë, si do të thuhej në një udhëzim të kësaj kohe, që në këto kurse e shkolla të venë të mësojnë në radhë të parë nxënës nga fshati e që, do të venë të punojnë në fshat”²¹.

Nxënësit me origjinë nga fshati apo klasa punëtore u tërhoqën në masën kryesore nëpërmjet një sistemi të gjerë bursash dhe gjysëm bursash. Ata vijuan të konsideroheshin si më të përshtatshëm e më të sigurt politikisht. Kriteret klasore në përzgjedhjen e nxënësve e studentëve, në gjithë sistemin e arsimit pedagogjik, erdhën duke u forcuar. Për çdo element që hynte në këtë sistem kryesore ishte qëndrimi politik i familjes, origjina shoqërore, përkushtimi ndaj “pushtetit” etj. Komitetet Ekzekutive në bashkëveprim me strukturat partiake dhe organizatat e masave, kalonin në “filtër” të dhënat e çdo nxënësit apo studenti. Udhëzimet rutinë edhe të kësaj periudhe hedhin dritë mbi faktin tashmë të njohur se përzgjedhja bëhej mbi bazën e kriterëve politike. Bazë e veprimtarisë vazhdonte të ishte vendimi i Sekretariatit të KQ të PPSH numër 122 i datës 31 mars 1959 sipas të cilit të drejtën e vazhdimit të studimeve e kishin të gjithë të rinjtë që kishin përfunduar shkollat shtatëvjeçare apo të mesme, por “që kishin qëndrim të mirë politik”. Pika dy përcaktonte në mënyrë taksative që “të mos u jepej e drejta e studimit bijve të tradhtarëve kryesorë ... si dhe atyre që nuk kanë qëndrim të mirë politik dhe zhvillojnë veprimtari armiqësore”²².

Trysnia e shtetit erdhi në rritje, duke goditur çdo shfaqje të “sektarizmit” apo “liberalizmit”, çdo “lajthitje” sado të vogël të strukturave të angazhuara në këtë problem, nga vija e përgjithshme e seleksionimit të kuadrit arsimor mbi bazën e kriterëve politike. Gjatë viteve 60-të, kur e drejta e “rishqyrtimit” të dokumenteve iu dha “degëve të kuadrit”, pranë Ministrisë së Arsimit e të Kulturës dhe Universitetit²³ politikat shtrënguese çuan në ndryshime të dukshme në vetë përbërjen shoqërore të mësuesve. Në vitin 1960 rreth 6,7 për qind e mësuesve ishin me origjinë punëtore dhe rreth 40,9 për qind vinin nga

²⁰ PPSH. *Dokumente kryesore*, Vëll.4, Tiranë: 1972, f. 183, Vendim i Plenumit të KQ të PPSH dt. 19.07.1962. “Mbi përmirësimin e mëtejshëm të punës për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrit”.

²¹ *AQSh*, Fondi 511, viti 1963, dos.3, fl. 156-157.

²² *Po aty*, viti 1970, dos. 73, fl. 45-46.

²³ *Po aty*, Fondi 14, viti 1966, dos. 118\1, dok. 22.11.1966, fl.30.

shtresat e varfra. Shtresat e pasura zinin 6.6 për qind të numrit të përgjithshëm të kuadrit mësimor. Në vitin 1963 figurojnë 8,3 për qind e kuadrit me origjinë punëtore dhe 43,9 për qind e tij, me origjinë të varfër²⁴

Për t'i paraprirë problemit të sigurimit të personalit mësimor-edukativ për shkollat e ardhshme tetëvjeçare, u thelluan masat për rritjen e efikasitetit të të gjithë sistemit të shkollave e kurseve pedagogjike. Deri në këtë periudhë institutet dyvjeçare i ndiqnin nxënësit që përfundonin shkollat e mesme, shkollën dyvjeçare të punëtorëve apo kurset 8 dhe 18 mujore. Nga viti shkollor 1962-1963 me vendim të Këshillit të Ministrave të RPSH, pranë Institutit Pedagogjik të Tiranës u hap një kurs njëvjeçar për përgatitjen e mësuesve në specialitetet matematikë-fizikë dhe biologji-gjeografi. Vendimi parashikonte organizimin edhe të dy shkollave trevjeçare të arsimit të përgjithshëm, ku do të përgatiteshin studentë të ardhshëm “për të vazhduar institutet pedagogjike dyvjeçare” sidomos për fakultetet e shkencave²⁵.

Masat e marra për përdorimin krahas shkollave të rregullta edhe të formave të shpejta ndonëse rritën sasinë e mësuesve të rinj të përgatitur deri në këtë periudhë ndikuan jo për mirë në nivelin shkencor e profesional të tyre. Kështu p.sh. shkolla dyvjeçare e punëtorëve deri në vitin 1962 përgatiti vetëm 30 mësues që u futën në arsimin fillor për shkak të nivelit të pamjaftueshëm të përgatitjes. Nxënësit, kryesisht të moshave të rritura (30-35 vjeç) kishin kryer arsimin shtatëvjeçar vite më parë, madje pjesa më e madhe ato të natës e me korrespondencë. Duke rezultuar të pasuksesshme paskëtaj ato u kthyen në shkolla kualifikimi²⁶.

Kurset 8 dhe 18 mujore ecën edhe këto me vështirësi. Dukuria më e shpeshtë mbetej ajo e pamundësisë për gjetjen e elementeve të përshtatshëm për degët e shkencave. Pjesëmarrësit në shumicën e rasteve kishin ndjekur gjimnazet e natës dhe, ata që vinin nga shkollat e mesme të ditës, dallonin për rezultate të ulëta. Me gjithë orvatjet për hartimin e planeve e programeve, të orientuara kryesisht nga lëndët e shkencave, rezultatet ishin të dobëta dhe pas vitit 1964 edhe këto u mbyllën. Diçka më mirë ecën gjimnazet trevjeçare, ndonëse edhe këto kishin mjaft vështirësi si shkolla të reja dhe pa shumë tradita. Planet dhe programet mësimore të pakonsoliduara, si rrjedhojë e uljes së afateve nga katër në tre vjet, lidhjet e munguara midis lëndëve, baza materiale e pamjaftueshme sidomos me laboratorë aq të nevojshëm për lëndët e shkencave sollën pengesa që reflektuan në cilësinë e kuadrit të përgatitur.

²⁴ *Po aty*, Fondi 511, viti 1964, dos. 95, fl. 10.

²⁵ *Gazeta Zyrtare*, viti 1962, nr.7, f. 165. Vendim i KM të RPSH nr. 291, dt. 16.08.1962. “Mbi disa masa për përgatitjen e shpejtë të kuadrit arsimor”.

²⁶ *AQSh*, Fondi 511, viti 1960, dos. 107, fl. 32-34.

Mesatarja e kalueshmërisë në këtë kategori shkollash nuk arriti të kalonte mbi 70-75 për qind²⁷.

Në qershorin e vitit 1963, Kuvendi Popullor i Shqipërisë dekretoi ligjin “Mbi riorganizimin e sistemit arsimor në RPS” zbatimi praktik i të cilit përbënte sfidën më të rëndësishme të kohës në fushën e shkollës. Në këtë kuadër nga viti 1960 deri në realizimin e reformës ishin përgatitur rreth 3400 mësues të rinj. Shkollat pedagogjike kishin arritur një farë stabiliteti. Sipas të dhënave të vitit 1964 në sistemin arsimor punonin 18.172 persona dhe direkt në shkollë 14.493 mësues, nga 11.000 në vitin 1960²⁸. Përpos 9500 arsimtarësh të përgatitur nëpërmjet shkollave të rregullta 510 përfunduan shkollat pedagogjike dyvjeçare me bazë filloren, 1676 pedagogjiken dyvjeçare dhe 600 kurset e shkollat e kualifikimit²⁹.

Masat e marra për përmirësimin e sistemit të arsimit pedagogjik reflektuan në rritjen e numrit të të diplomuarve duke çuar në zbutjen e nevojave për kuadro. Në këtë kontekst balanca gjithnjë e më tepër fillon e anon nga shkollat e rregullta si rruga kryesore e përgatitjes së mësuesve të rinj. Duke filluar nga viti shkollor 1964-1965 gjimnazet trevjeçare dhe shkollat dyvjeçare të kualifikimit nuk pranuan më nxënës të rinj³⁰.

Në përputhje me nevojat e zgjerimit të kategorive të ndryshme arsimore, kërkesa për kuadro të reja ndryshoi. Ecuria e arsimit fillor ndoqi linjën e shtrirjes graduale duke lënë pas ritmet e përsheptuara të viteve të para. E futur në fazën e konsolidimit treguesit e saj do të ndiqnin ato të rritjes natyrore të popullsisë. Rrjedhimisht kërkesa erdhi në ulje nga një mesatare vjetore prej 1200-1400 në 350-400 mësues të rinj në vit. Kjo çoi edhe në pakësimin e numrit të nxënësve në shkollat pedagogjike nga 1800 në 1100 në vit³¹.

Në kuadrin e zbatimit të reformës arsimiti tetëvjeçar mbeti prioritet i saj. Në këtë kontekst roli i instituteve pedagogjike u rrit dukshëm. Vëmendja e strukturave arsimore u fokusua në forcimin cilësor të arsimit të mesëm dhe të lartë pedagogjik. Me gjithë përmirësimet e bëra, nuk është e vështirë të konstatohet se studentët nuk arrinin të zotëronin sa duhej aftësitë për të punuar si mësues në shkollat tetëvjeçare apo ato të mesme. Gjithnjë e më tepër rilevohet si një kërkesë e kohës, nevoja e përgatitjes së një kuadri të aftë e me nivel shkencor e profesional. Pikënisja ishte rishikimi i planeve e programeve të shkollave që përgatisnin mësues në funksion të kërkesave të reja. Zhvillimet në këtë fushë çuan në forcimin e programeve të lëndëve të formimit të

²⁷ *Po aty*.

²⁸ *Po aty*, Fondi 14, viti 1964, dos. 19, fl. 1-2.

²⁹ *Po aty*, Fondi 490, viti 1964, dos. 95, fl.2-3.

³⁰ *Po aty*, dos. 574, fl.4, Vendim i Kësh. Minis. Nr.311, dt. 10.08.64 “Mbi disa masa në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë”.

³¹ *Po aty*, Fondi 14, viti 1964, dos. 202, fl.7-8.

përgjithshëm, në zbutjen e shpërpjestimeve me lëndët e formimit profesional, në rritje të sasisë të orëve të praktikave pedagogjike etj.³²

Forcimi relativ i sistemit të arsimit pedagogjik, krijoi më tepër hapësira për përgatitjen e kuadrit arsimor. Gjithsesi dukuria kryesore e kësaj periudhe mbetet rritja sasiore e shoqëruar nga mangësi në nivelin cilësor të tyre. Prurjet më të mëdha me mësues të rinj u vërejtën në arsimin tetëvjeçar dhe atë të mesëm. Sipas të dhënave të vitit shkollor 1965-1966, nevojat e shkollave fillore plotësoheshin mjaftueshëm. Në këtë kategori arsimore kishin hyrë rreth 2000 kuadro të reja ose 38 për qind e sasisë së përgjithshme të arsimtarëve që punonin në shkollën fillore në klasat e larta të 7 dhe 8 vjeçareve edhe 2000 të tjerë baraz me 40 për qind të kuadrit të këtyre shkollave dhe në arsimin e mesëm 500 ose mbi 50 për qind e mësuesve të shkollave të mesme³³. Pavarësisht se niveli i këtij kuadri linte për të dëshiruar rritja absolute pati impakt pozitiv në zbutjen e kërkesave që shtroi zgjerimi i shkollës dhe zbatimi i reformës arsimore.

*
* *
*

2. Zhvillimet në sistemin e kualifikimit

Përgatitja e mësuesve me nivelin e duhur kulturor e profesional për të përballuar kërkesat e shkollës së riorganizuar përfaqësonte një nga problemet e mprehta për kohën. Personeli mësimor-edukativ që në fillim u përball me një mori çështjesh, zgjidhja e të cilave në shkallë të fundit, u kushtëzua nga niveli i përgatitjes dhe i kualifikimit. Me zbatimin e reformës gjithnjë e më tepër nga mësuesit kërkohej dije dhe kulturë, aftësi dhe pasion për të punuar me nxënësit. Mësimi dhe edukimi sipas konceptit të partisë-shtet përfaqësonin në vetvete një proces aktiv, të ndërlikuar dhe shumëplanësh, që i kontribuonte krijimit të “njeriut të ri”. Nisur nga ky këndvështrim, roli dhe niveli i mësuesit ishin përcaktues për vetë rezultatet e këtij procesi. Padyshim që ky synim, u shoqërua me përpunimin e politikave, që do të përvijonin linjat brenda të cilave ai do të kanalizohet. *Po aq sa politika ndikoi në formësimin e kuadrit, të përshtatshëm për të përmbushur “misionin” e edukimit komunist të të rinjve, po aq ajo përcaktoi edhe ecurinë e zhvillimeve në fushën e kualifikimit.*

Njohja me kërkesat e reformës, zbatimi i planeve, programeve apo teksteve të reja, përzgjedhja e metodave më të përshtatshme, do të nënkuptonin më shumë përkushtim, por edhe nivel të lartë përgatitje kulturore e profesionale. Problemi ndërlikohej kur bëhej fjalë për aftësimin e një personeli

³² *Mësuesi*, 17 prill 1964, fl.2. Artikulli “Kuadri i ri arsimor dhe kërkesat e riorganizimit”.

³³ *AQSh*, Fondi 14, viti 1965, dos. 190, fl. 1-2.

mësimor, që në masën 66 për qind nuk kishte arsim të mjaftueshëm³⁴. Treguesit më të mirë i takonin arsimit të lartë, i cili për vetë natyrën e tij nuk mund të punonte me kuadro të një niveli çfarëdo. Në arsimin e mesëm ishte tentuar të ruheshin parametra të pranueshëm. Më e dobët ishte gjendja e mësuesve të shkollave shtatëvjeçare.

Sigurimi i kuadrit nëpërmjet kombinimit të rrugëve dhe formave të rregullta me ato të përsheptuara, pavarësisht efekteve zbutëse në përballimin e nevojave të zgjerimit, la pasojë në procesin e përgatitjes së mësuesve të rinj. Në këto rrethana kualifikimi mori karakterin e një nevojë të dyfishtë, atë të paisjes me arsimin e duhur dhe njëheri të rritjes së aftësive të mësuesve për t'iu përgjigjur kërkesave të shkollës. Zgjidhja në mënyrën dhe shkallën e duhur e problemeve të kësaj natyre, kushtëzoi ndërmarrjen e masave të reja për zhvillimin dhe konsolidimin e gjithë sistemit ekzistues. Nëpërmjet formave tradicionale tashmë të njohura si: mësimi me korrespondencë, kurset, seminarët, konferencat shkencore, rrethet metodike, komisionet e lëndëve etj. u synua përmirësimi i rezultateve të cilat deri në këtë periudhë linin për të dëshiruar. Kjo shënoi edhe pikënisjen e një procesi sistematik që u shtri edhe tej viteve të marra në studim.

Pjesë integrale dhe e rëndësishme e sistemit të kualifikimit do të vazhdonte të ishte shkollimi nëpërmjet arsimit me korrespondencë. I aplikuar që nga vitet 50-të me gjithë defektet që mbartte mbetej një nga burimet e rëndësishme të përgatitjes dhe aftësimit të kuadrit. Në rrafshin praktik, masat e deriatëhershme kishin dhënë disa rezultate. Deri në vitin 1960, rreth 1200 mësues kishin plotësuar studimet. Sipas të dhënave të kohës, më problematike ishte vijimësia e arsimit me korrespondencë nga mësuesit e shkollave fillore dhe shtatëvjeçare të fshatit, që realisht përbënin shumicën e mësuesve në shkallë vendi. Në shkollat pedagogjike p.sh. nga 1440 të regjistruar në vitin 1960-1961, u diplomuan 376 ose 24,8 për qind e tyre. Pak a shumë e njëjta gjendje ishte dhe në institutet pedagogjike dyvjeçare ku, nga 800 studentë u diplomuan vetëm 212 mësues ose 26,4 për qind, ndërkohë që, treguesit në fakultetet e mësuesisë pranë Universitetit nuk kaluan mbi 13 për qind³⁵.

Në analizën e dokumentacionit të periudhës shquhen lehtësisht disa arsye më kryesore, të cilat do të mundohemi t'i parashtrojmë. Fakti, që shpesh marrja e arsimit me korrespondencë trajtohej më tepër si çështje e individit se sa e shtetit, dukej se nuk ndikonte për mirë. Për sa kohë do të mungonin mekanizmat që do ta bënin atë tërheqës dhe të leverdishëm për masën e mësuesve, problemi do të vijonte të mbetej në rrafshin e propagandës.

³⁴ *Arsimi Popullor*, viti 1961, nr.1, f. 20-25. Fjala e Zv. Ministrit të Arsimit, K. Ylli, "Puna me kuadrin".

³⁵ *AQSh*, Fondi 511, viti 1960, dos. 19, fl. 15-17.

Praktika e gabuar e seksioneve të arsimit për t'u mjaftuar me regjistrime, këto shpesh nga zyra dhe të detyruara, anashkalimi i mundësive dhe dëshirave të vetë mësuesve, natyrisht do të prodhonin rezultate të dobëta. Mungesës së profesionalizmit dhe paaftësisë për të menaxhuar situatën, i shtohet edhe ndikimi i disa faktorëve objektivë. Për disa zona të largëta si: Tropoja, Burreli, Skrapari, Kukësi, Tepelena etj. pengesë ishte largësia e konsiderueshme nga qendrat e konsultimit si dhe mungesa e teksteve dhe dispensave. Në të tilla rrethana një numër i mirë mësuesish sidomos nga fshati, ndonëse regjistroheshin nuk arrinin të shlyenin provimet³⁶.

Të ndodhura para këtij realiteti, strukturat e larta shtetërore detyrohen të pranojnë në informacionet e tyre se: “po të ecim me ritmin e deritanishëm në përgatitjen e mësuesve me arsimin përkatës në shkollat e mbrëmjes dhe me korrespondencë, rrezikohet seriozisht sigurimi i kuadrit të nevojshëm ... dhe realizimi i detyrave të mëdha të riorganizimit të shkollës”³⁷. Të gjitha gjasat ishin se po të ndiqej kjo rrugë, niveli i pamjaftueshëm i përgatitjes së mësuesve, rrezikonte të bëhej një pengesë serioze për ecurinë e mëtejshme të arsimit në vend. Nisur nga gjendja që tashmë nuk mund të fshihej, strukturat e angazhuara për këtë problem, u përpoqën ta zgjidhin këtë ngërç nëpërmjet përfshirjes më aktive në këtë proces të organizatave shoqërore si dhe të vetë mësuesve. Ato u fokusuan para së gjithash, në marrjen e masave për vendosjen e bashkëveprimit të munguar midis tyre. Shkollat, komitetet ekzekutive, organizatat e partisë, ato të bashkimeve profesionale, sipas udhëzimeve të reja duhej të ndryshonin para së gjithash konceptin, duke e konsideruar atë si një detyrë të rëndësishme shtetërore. Pjesë e procesit do të ishte kujdesi më i mirë për anën organizative si, hartimi i evidencave të rregullta, përpunimi i planeve më reale, pajisja në kohë me tekste, mbarëvajtja e qendrave të konsultimit etj.³⁸

Shqetësimi për nevojën e ngritjes së nivelit kulturor e profesional të mësuesve, gjeti pasqyrim edhe në organet e shtypit, sidomos në atë të specializuar. Gazeta “Mësuesi” në një artikull të nëntorit të vitit 1961 titulluar “Më shumë vëmendje arsimit me korrespondencë”, do të evidenconte faktin tashmë të njohur se ritmi i paisjes së mësuesve me arsimin përkatës “ishte shumë i ngadalshëm” dhe se ndryshimi i shpejtë i gjendjes së krijuar “bëhej gjithnjë e më tepër një kërkesë e kohës”³⁹.

Në këtë kuadër, u tentua për përmirësime në sistem. Duke filluar nga viti shkollor 1961-1962, në organikën e shkollave pedagogjike u shtua një nëndrejtor që ndiqte ecurinë e arsimit me korrespondencë, u zgjerua rrjeti i

³⁶ *Po aty*, Fondi 511, viti 1939, dos. 71, fl. 2.

³⁷ *Po aty*, viti 1960, dos. 19, fl. 16-17.

³⁸ *Po aty*, Fondi 511, viti 1960, dos. 45, fl.1-4. Nga urdhëri i Ministrisë të Arsimit, nr.12, dt. 10.09,1960.

³⁹ *Mësuesi*, 10 nëntor 1961, f. 2.

shkollave që organizonin konsultime në zona të thella si: Puka, Shupenza, Ballshi etj. Me vendim të Këshillit të Ministrave, për mësuesit me korrespondencë të Fakultetit të Shkencave, përveç konsultimeve rutinë u organizuan kurse një mujore në Tiranë, ku këto të fundit me shpenzimet e shtetit përgatiteshin për provime etj Njëheri vendimi u krijoi lehtësi mësuesve që do të vijonin institutet dyvjeçare apo fakultetet e mësuesisë në Universitet, me organizimin e qendrave të reja të konsultimit pranë vendbanimeve të tyre si, në Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Gjirokastër etj.⁴⁰

Masat e para e zbutën disi problemin por gjithsesi rezultatet edhe për disa kohë mbetën të parëndësishme. Sipas të dhënave të vitit shkollor 1961-1962 në shkollat pedagogjike, nga 64 për qind e mësuesve me korrespondencë vetëm 34 për qind ishin fitues të provimeve kur, në institutet pedagogjike nga 42 për qind e të regjistruarve u diplomuan vetëm 13,7 për qind e tyre. Nga rrethi i Pukës p.sh. nuk figuronte asnjë i regjistruar, nga ai i Kukësit vetëm rreth 9 për qind e mësuesve. Rrethe të tilla si Burreli, Peshkopia, Pogradeci, Lushnja, Kruja, Saranda nuk kishin arritur të diplomonin më tepër se 1-2 mësues në vit, etj.⁴¹

Krijimi nga organizmat shtetërore i një infrastrukture efikase që do t'i ndihmonte ecurisë së procesit, mbeti ende problem i pazgjidhur. Format dhe rrugët ishin të mjaftueshme por “e keqja qëndronte” në mosfunksionimin e rregullt. Në një nga analizat e Ministrisë së Arsimit si arsye kryesore konsiderohej puna “krejtësisht e pamjaftueshme dhe pa përgjegjësi e seksioneve të arsimit”, nënvleftësimi, qëndrimi “indiferent” dhe sidomos “përpjekjet e vakta” për ndërgjegjësimin e arsimtarëve që marrja e arsimit përkatës. Kjo ishte “një detyrë shtetërore dhe jo diçka që varet nga dëshira e tyre”. Realisht ky konstatim ishte i bazuar dhe me të drejtë tërhiqej vëmendja se kishte ardhur momenti “që këtij problemi t'i jepej një zgjidhje e plotë dhe urgjente”⁴².

Diçka më mirë eci veprimtaria në këtë fushë pas zbatimit të reformës në vitin 1963. Strukturat e larta shtetërore dhe partiake rritën presionin mbi seksionet arsimore dhe drejtoritë e shkollave, për të mos lejuar që mjetet financiare “sacrificat” si do të thuhej në një nga udhëzimet rutinë “që jemi të detyruar të bëjmë në këtë çështje “të çohen dëm por në të kundërtën “të shfrytëzohen në maksimum”⁴³.

Sipas informacioneve që Ministria e Arsimit u dërgon strukturave më të larta partiake, gjendja ishte përmirësuar por, ende linte për të dëshiruar. Në

⁴⁰ *Arsimi Popullor*, viti 1961, nr.1, f. 26-27. Nga raporti i zv. ministrit të Arsimit K.Ylli “Puna me kuadrin”.

⁴¹ *Po aty*, viti 1962, nr.4, f. 45-46. Raport i Th. Deljanës “Mbi rezultatet e vitit shkollor 1961-62”.

⁴² *AQSh*, Fondi 511, viti 1961, dos. 17, fl. 31.

⁴³ *Po aty*, viti 1963, dos.3, fl. 156.

shkollat pedagogjike, nga 1084 të regjistruar për vitin shkollor 1963-1964, kishin fituar provimet 514 mësues. Për periudhën 1960-1964 shkalla e përfitimit vijoi të mbetej relativisht e pakët, sidomos për kategoritë më të larta. Në institutet pedagogjike dyvjeçare u diplomuan 238 mësues dhe në Universitet vetëm 131 prej tyre⁴⁴.

Shqetësimi mbi ecurinë dhe efikasitetin e sistemit të arsimit me korrespondencë, do të zinte vend herë pas here në shtypin e kohës. Gazeta “Mësuesi”, duke e vlerësuar si “detyra numër një midis detyrave të tjera kryesore” do të tërhiqte vëmendjen në faktin se, “problemi i arsimit me korrespondencë të arsimtarëve në përgjithësi nuk po gjente akoma zgjidhje”⁴⁵. I gjithë dokumentacioni i analizuar mbështet konstatimin që përpjekjet e bëra ndonëse sollën disa ndryshime në arsimin me korrespondencë, ky i fundit edhe për shumë kohë mbeti “pika e dobët” e gjithë sistemit të përgatitjes dhe kualifikimit të mësuesve.

Aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë kualifikuese, që mori rëndësi të veçantë gjatë periudhës së riorganizimit të shkollës, ishte ai i aftësisimit profesional e metodik i kuadrit.

Kuptimi nga ana e mësuesve i thelbit të reformës, i kërkesave dhe vështrësive gjatë zbatimit të saj praktik, i shtyu strukturat shtetërore drejt intensifikimit të masave për gjetjen e rrugëve dhe mundësive të reja si dhe, shfrytëzimin e kapacitetit të formave ekzistuese. Deri në këtë periudhë, kualifikimi profesional i mësuesve të të gjitha kategorive arsimore realizohej në dy nivele, në qendër nëpërmjet Institutit të perfeksionimit dhe 16 kabineteve pedagogjike dhe, pranë shkollave ku funksionin këshillat pedagogjike dhe komisionet e lëndëve, struktura këto të ngritura gradualisht gjatë viteve 50-të⁴⁶. Kurset e kualifikimit si forma më kryesore, organizoheshin nga Instituti i Perfeksionimit apo kabinetet pedagogjike. Në to merrnin pjesë mësuesit pa arsim përkatës, me qëllim përfitimi të njohurive bazë për lëndët që ato jepnin, metodikën e tyre, punët praktike dhe ato laboratorike etj. Për mësuesit e shkollave të mesme, më shpesh u organizuan kurse perfeksionimi për lëndët e shkencave. Krahas tyre u aplikuan edhe forma të tjera si seminarët, diskutimet për probleme të ndryshme të arsimit, botimi i literaturës pedagogjike, përhapja e eksperiencës pozitive etj. I gjithë ky sistem synonte të ndihmonte në rritjen e aftësive profesionale të kuadrit mësimor.

Fillimisht, Instituti i Perfeksionimit nuk mundi ta drejtonte në tërësinë e tij çështjen e kualifikimit, të përballonte furnizimin me materialet e duhura metodike dhe, të ndihmonte drejtpërsëdrejti kabinetet pedagogjike në organizimin e punës. Sigurimi i drejtuesve të kualifikuar dhe metodistëve me

⁴⁴ *Po aty*, viti 1964, dos. 95, fl. 7-8.

⁴⁵ *Mësuesi*, 14 shkurt 1964, fl. 2.

⁴⁶ *AQSh*, Fondi 511, viti 1962, dos. 26, fl. 2.

njohuri të mjaftueshme, për të rritur nivelin e kësaj veprimtarie, përbënte gjithnjë një problem të pazgjidhur. Defekteve organizative i shtohet edhe kujdesi i pamjaftueshëm i seksioneve arsimore që shpesh, e konceptonin kualifikimin si çështje vetëm të Institutit të Perfeksionimit apo të kabineteve pedagogjike.

E njëjta tablo vërehet edhe në punën metodike, të zhvilluar pranë qendrave të rretheve dhe shkollave. Me gjithë përpjekjet nuk ishte arritur të sigurohet lidhja e duhur, midis punës metodike dhe problemeve kryesore të procesit mësimor. Tërheqja më tepër ndaj formës dhe nënvlefësisë i përmbytjes çuan në formalizëm, në zhvillimin e një veprimtarie standarde pa ngjyrimet e nevojshme që lidheshin me nivelin, nevojat, veçoritë e punës të mësuesit në një rreth të caktuar me problemet e veçanta të qytetit nga ato të fshatit, që natyrshëm reflektuan në shkallën e ulët të përfitimit⁴⁷.

Përpos të tjerave, impakt negativ duket se pati drejtimi i procesit pa profesionalizmin e duhur sidomos në rrethe e zona të largëta. Horizonti i ngushtë i drejtuesve por edhe i arsimtarëve, rrjedhë nga kjo e përdorimit të kufizuar të literaturës metodike e pedagogjike të botuar, shfrytëzimi i pakët i shtypit pedagogjik la pasoja. Për hir të së vërtetës duhet pranuar se shtypi arsimor ishte shtuar dhe se botimet e literatura profesionale nuk mungonte. Problemi qëndronte në shkallën e ulët të përdorimit. Mangësi vëreheshin edhe në punën metodike të shkollave. Një veprimtari më e mirë u zhvillua në shkollat e mëdha, me fuqi mësimore të konsiderueshme. Por në përgjithësi përgatitja metodike mbeti e paorganizuar e formale, në shkollat e vogla shtatëvjeçare sidomos në fshat. Duke patur parasysh faktin se këto të fundit përbënin shumicën e shkollave të vendit, problemi merrte përmasa serioze⁴⁸.

Në prag të zbatimit të Reformës çështja u bë më e mprehtë. Sipas një udhëzimi të Ministrisë së Arsimit të shkurtit të vitit 1963, strukturat arsimore duhej të bënin të gjitha përpjekjet për përfshirjen e mësuesve të kategorive shkollore ku do të fillonte reforma “në kurse mbrëmjeje, pa shpëputje nga puna në qytete dhe fshatra”. Në to do të zërtheheshin tema mbi thelbin e riorganizimit të shoqëruar këto edhe me dhënien e njohurive praktike në lëndë të tilla, si: biologji, kimi, matematikë, gjeografi etj.⁴⁹

Duke pranuar gjendjen dhe nevojën e ndryshimit, vetë Ministri i Arsimit në një mbledhje organizuar në Kryeministri në korrikun e vitit 1963 do të evidentonte faktin se kishte ardhur momenti i forcimit të masave dhe i kërkimit të rrugëve të reja. “Këshillat pedagogjike të shkollave, rrethet dhe komisionet metodike brenda shkollave, si organizma themelore të punës metodike me

⁴⁷ *Po aty*, fl. 13-14.

⁴⁸ *Po aty*, viti 1963, dos. 3, fl. 1-2. Urdhër i Ministrisë së Arsimit, nr. 4, dt. 9.02.63.

⁴⁹ *Po aty*.

mësuesit sipas tij duhej të merreshin më shumë me problemet aktuale të shkollës, që për të arritur rezultate në punën metodike duhej të forcohej kuadri drejtues i qendrave metodike “me mësues të kualifikuar” dhe që të gjitha strukturat arsimore ishte e nevojshme t’i kushtonin “më shumë vëmendje organizimit të praktikumeve, seminareve të shkurtra, për çështje konkrete” ku të shkëmbehej “eksperienca më e mirë” etj.⁵⁰

Në këtë kuadër, gjatë vitit 1963-1964 Instituti i Perfeksionimit të mësuesve organizoi kurse 8-15 ditore për njohjen e mësuesve të shkollave fillore me problemet e riorganizimit. Po kështu në kurse kualifikimi 1 mujore u përfshinë mësues të shkollave 7-vjeçare dhe të mesme, ndonëse reforma do të zbatohet më vonë në këto kategori arsimore. Kurset e zhvilluara në qendër u përqendruan në zberthimin e përmbajtjes së lëndëve mësimore dhe praktikumet, por jo aq sa duhej në zgjerimin e horizontit pedagogjik e shkencor të mësuesve.

Rëndësi iu kushtua organizimit edhe të seminareve, si një formë tjetër e kualifikimit. Sipas një udhëzimi të Ministrisë së Arsimit të kësaj periudhe, me mësuesit e shkollave fillore organizoheshin seminare 10-12 ditore. Në rrethet me shumë mësues rekomandohej organizimi i seminareve të grupuara. Në to do të përfshiheshin rreth 50-60 arsimtarë, që do të njiheshin kryesisht me planet e programet e reja mësimore dhe eksperiencën pozitive të shkollave fillore eksperimentale. Me mësuesit e kategorive më të larta do të zbertheheshin lëndë të veçanta si gjuha shqipe, matematika, biologjia e gjeografia.

Instituti i Perfeksionimit do të organizonte në qendër tri kategori seminaresh. Në kategorinë e parë përfshiheshin mësuesit e shkollave 7-vjeçare dhe të atyre që ktheheshin në tetëvjeçare. Kategoria e dytë ishin seminarët me metodistët dhe instruktorët që drejtonin seminarët e rretheve dhe kategoria e fundit, ato me kuadrot drejtuese të arsimit dhe drejtorët e shkollave shtatëvjeçare apo të mesme ku do të zbatohet fillimisht riorganizimi⁵¹.

Strukturat shtetërore pretendonin që veprimtaria në këtë fushë të futej në një stad të ri dhe kualifikimi profesional që në një farë mënyre kushtëzonte vetë nivelin e mendimit pedagogjik, të vihej në të ardhmen mbi baza më të organizuara. Realisht, zhvillimet e periudhës evidencuan gjithnjë e më tepër faktin se, sistemi vuante dhe vazhdoi më tej të vuante dobësi që lidheshin me vetë mënyrën se si ai ishte konceptuar dhe organizuar.

*

*

*

⁵⁰ *Mësuesi*, 26 korrik 1963, fl. 1-2. Nga raporti i Ministrisë së Arsimit, Manush Myftiu “Mbi disa çështje të riorganizimit të shkollës”.

⁵¹ *AQSh*, Fondi 511, viti 1963, dos. 23, fl. 51-52.

3 – Dukuri dhe tendenca

Për analizën e procesit në gjithë shtrirjen e tij tërheqim vëmendjen që në fillim se burimi kryesor mbeten të dhënat zyrtare. Nisur nga kriteret e ndjekura gjatë periudhës komuniste në ofrimin selektiv të dokumentacionit për publikun, pas përpunimit dhe kalimit në filtrin e kontrollit nga lart, ky i fundit mbetet i diskutueshëm. Gjithsesi është tentuar të bëhen plotësime me burime të tërthorta. Pavarësisht nga kufizimet, një përjasje për evidencimin e dukurive dhe tendencave kryesore është i mundshëm.

Nisur nga krahasimi i të dhënave të fillimit me ato të fundit të periudhës, rezulton si tendencë në rritje ritmi i shpejtë në përgatitjen e kuadrit dhe zhvillime relative në kualifikimin e tij. Këto shoqërohen këto me ulje ngritje të kushtëzuara nga kërkesat e zgjerimit të kategorive arsimore. Numri i përgjithshëm i mësuesve dhe shkalla e arsimit përkatës ndryshoi sipas tabelës 1⁵².

Tabela 1

| Kategoria e arsimit | Kadro gjithsej | | % e kuadrit me arsim përkatës | |
|---------------------|----------------|-----------|-------------------------------|-----------|
| | 1959-1960 | 1960-1965 | 1959-1960 | 1960-1965 |
| Arsimi fillor | 5100 | 7523 | 49% | 89,8% |
| Arsimi 7-8 vjeçar | 2573 | 5300 | 23% | 54,7% |
| Arsimi i mesëm | 845 | 1470 | 60% | 72% |

Brenda kësaj tendence vërehen dallime që lidhen me kategoritë e ndryshme shkollë, rajonet nga vinte kuadri, origjina shoqërore, mosha, seksi etj. Nga pikëpamja sasiore, ritmet e shtimit ashtu si edhe u ilustrua në tabelë, rezultojnë të konsiderueshme. Në fund të periudhës treguesit më të lartë i takojnë kuadrit të arsimit tetëvjeçar dhe brenda tij, ciklit të lartë (kl. V-VIII). Në arsimin fillor nuk vërehet më ai bum zgjerimi si i viteve të mëparshme për faktin e thjeshtë se, tashmë ai është i shtrirë në të gjithë vendin. Duke filluar nga mesi i viteve 60-të, treguesit ndjekin ritmet e shtimit natyror të popullsisë. Ndryshimet relative të vërejtura në ciklin e lartë të shkollës 8-vjeçare dhe në arsimin e mesëm e të lartë, duhet thënë se u favorizuan nga zgjerimi i mëtejshëm i tyre sidomos nga fundi i periudhës së analizuar.

Për sa i takon përmirësimeve në fushën e kualifikimit mendojmë se ndikuan dy faktorë:

Së pari, në shkollat e të gjitha kategorive u futën një numër i konsiderueshëm mësuesish të përgatitur në sistemin e arsimit pedagogjik, gjë që reflektoi në përmirësimin e nivelit të përgjithshëm të kuadrit, dhe *së dyti*, përpjekjet për forcimin e sistemit të kualifikimit, pavarësisht mangësive sollën ndryshime qoftë edhe relative.

⁵² Tabela është përpunuar mbi bazën e dy burimeve dokumentare:

- *AQSh*, Fondi 511, viti 1960, dos. 114, fl. 38-40.

- *Po aty*, Fondi 14, viti 1965, dos. 195, fl. 3-4.

Pamje interesante vërehen në evolucionin që pësoi kuadri mësimor sipas origjinës dhe gjendjes shoqërore, pasqyrim ky i politikave të ndjekura nga shteti komunist. Gjatë ecurisë së procesit evidencohet si tendencë e periudhës, tkurrja e vazhdueshme e numrit të mësuesve të rinj me origjinë nga shtresat e mesme dhe të pasura të qytetit dhe fshatit si dhe, rritja e peshës së elementeve me gjendje punëtore e fshatare. Në mbështetje të këtij konstatimi po japim të dhënat e tabelës 2:⁵³

Tabela 2

| Shkolla | Nxënës në vitin 1964 | | | Nxënës që do të përfundojnë në vitet 1964-1967 | | |
|---|----------------------|----------|----------|--|----------|----------|
| | gjithsej | qytetarë | fshatarë | gjithsej | qytetarë | fshatarë |
| 1-Shkolla Pedagogjike 2 vjeçare | 1339 | 170 | 1169 | 940 | 120 | 820 |
| 2-Shkolla Pedagogjike katër vjeçare | 4859 | 1661 | 3191 | 3220 | 1100 | 2120 |

Sigurisht kjo gjendje u ushqye dhe u kushtëzua më së paku nga tre faktorë të cilat do të mundohemi t'i japim përmbledhtazi.

Së pari, faktori politik ishte më kryesori. Sipas konceptit të udhëheqjes komuniste elementët me origjinë të varfër nga fshati dhe qyteti, konsideroheshin “shtylla” e pushtetit popullor. Fillimisht pesha e mësuesve të vjetër e të rinj me origjinë punëtor e fshatar i mesëm dhe i varfër ishte më i pakët. Kjo shpjegohet me numrin e kufizuar të elementeve që mund të ndiqnin sistemin e arsimit pedagogjik. Në kushtet kur nevojat për mësues ishin të larta për një periudhë kohe u tërhoqën edhe elemente me origjinë nëpunës apo nga shtresat e mesme dhe të larta por gjithnjë “të lidhura me pushtetin”. Me kalimin e viteve kur niveli i përgjithshëm i arsimit të popullsisë erdhi në rritje shteti vijoi të përpunonte politika stimuluese që çuan detyrimisht në ndryshime të përbërjes shoqërore. Nëpërmjet një sistemi të gjerë bursash dhe gjysmë bursash në arsimin pedagogjik u tërhoq një numër gjithnjë e më i madh elementësh me origjinë të varfër sidomos nga fshati.

Së dyti, zhvillimet e brendshme të vetë sistemit shkollor patën impakt pozitiv në zgjerimin e mëtejshëm të arsimit, në gjithë territorin e vendit. Deri në mesin e viteve 60-të burimi kryesor i sigurimit të kuadrit të mesëm dhe sidomos atij të lartë, ishin elementët më tepër nga qyteti dhe zona me zhvillim arsimor të avancuar. Kjo shpjegohej me faktin që, kontingjenti i nxënësve që kishin përfunduar arsimin shtatëvjeçar nga këto zona apo kategori ishte më i lartë. Dora-dorës me kalimin e viteve dhe zgjerimin e arsimit shtatëvjeçar në fshat u bë e mundur tërheqja e sa më shumë nxënësve në gjithë sistemin e arsimit pedagogjik.

⁵³ *Po aty*, Fondi 511, viti 1964, dos. 95, fl. 18-25.

Së treti, shteti mbetej i interesuar për të mbajtur të lartë numrin e mësuesve nga fshati edhe për një arsye tjetër, përveç asaj të origjinës shoqërore. Shqipëria ishte një vend me mbizotërim të popullsisë fshatare. Kuptohej që zhvillimet më të mëdha në drejtim të masivizimit të shkollës, sidomos për kategoritë e saj bazë, lidheshin pikërisht me fshatin. Elementët nga qyteti ishin më pak të interesuar të shërbenin në fshat apo zona të thella, kur ata me origjinë nga fshati e kishin më të lehtë të punonin në komunitetin nga i cili vinin. Kjo zgjidhte edhe mjaft probleme teknike, që lidheshin me sigurimin e kushteve të jetesës e të banimit të mësuesve. Deri në vitin 1962, rreth 85,66 për qind e mësuesve të arsimit fillor, shtatëvjeçar dhe të mesëm shërbenin pranë vendbanimit të tyre⁵⁴. Brenda këtij treguesi të përgjithshëm, vërehen edhe shpërpjesëtime midis rajoneve të zhvilluara dhe më pak të zhvilluara.

Së fundi, në gjithë procesin e përgatitjes dhe kualifikimit të kuadrit “thembra e Akilit” mbetej mësuesi. Pavarësisht se në pamjen e parë dukej se roli i tij u vlerësua, u anashkaluan disa elemente të rëndësishme si shkalla e përgatitjes, kushtet në të cilat ai jetonte dhe punonte dhe mbi të gjitha predispozicioni për t’u përfshirë aktivisht në këtë proces.

Një pjesë e mirë e mësuesve, sidomos ata të hallkave të ulëta shkollore për shkak edhe të përgatitjes së tyre të shpejtë, kishin mangësi të theksuara në formimin kulturor e profesional. Kjo përbënte kategorinë e mësuesve që e kishin tepër të vështirë të punonin në mënyrë individuale dhe të arrinin rezultate.

Jo pa rëndësi ishte fakti që shpesh mësuesit ndjeheshin të demotivuar. Sistemi i kualifikimit nuk arrinte të çonte në evidencimin e punës së një mësuesi të mirë nga ai i zakonshëm. Për më tepër, pavarësisht propagandës, thellë thellë mësuesit ishin të ndërgjegjshëm se me gjithë aftësimin e tyre shumica do të vazhdonte të punonte në fshat, me kushte të vështira banimi dhe trajtim financiar me dallime të parëndësishme.

Një arsye më shumë ishte se me gjithë dëshirën e mirë dhe përkushtimin mësuesit e kishin shpesh të pamundur t’i përgjigjeshin të gjitha kërkesave të shkollës dhe më gjerë. Nuk duhej harruar se mësuesi përfaqësonte “një figurë të rëndësishme shoqërore”, nga i cili kërkonin të gjithë, shkolla, organizatat shoqërore, komuniteti ku ai jetonte etj. Por sa ishte ai në gjendje ta përballonte këtë ngarkesë shpesh harrohej.

Gjithsesi analiza e dokumentacionit na çon në përfundimin se procesi i përgatitjes dhe kualifikimit të kuadrit arsimor në përgjithësi u bë i sforcuar. Format dhe rrugët e përdorura çalonin si nga pikëpamja e dhënies së kulturës së përgjithshme ashtu edhe asaj profesionale metodike. Për rrjedhojë ndonëse pati ndryshime të konsiderueshme sasiore në raport me fillimin e periudhës, i gjithë sistemi sidomos ai i kualifikimit nuk arriti të konsolidohej si duhej. Kjo çoi në rezultate të pamjaftueshme që padyshim, lanë gjurmë në vetë nivelin cilësor të shkollës shqiptare të këtyre viteve.

⁵⁴ *Po aty*, Fondi 14, viti 1962, dos. 142, fl. 6.

*S u m m a r y*THE ALBANIAN TEACHERS AND THE REORGANISATION
OF THE SCHOOLING SYSTEM
(1960-1965)

The changes experienced by the Albanian schooling system in the beginning of the 60s with the implementation of the reform for the reorganisation of the education was defining for the course of the personnel problems. Common for the whole of the period is the pursuing of the same earlier policies that did not generate overturn. It is the case for developments within the same political system which were dictated due to the need for its consolidation. In addition, the Labour Party of Albania took many measures to obtain a sufficient number of qualified teachers, professionally trained and especially formed as "missionaries" of the communist education for the new generations. These were the two fundamental directions of the official Albanian policy until the full fall of the system in the 90s.

In resolving issues of the education-teaching staff, was operated in the same way and were applied methods as in the previous periods. Although it should be noted that was attempted an increase in the efficiency. In this regard, the new measures that were taken aimed the development and consolidation of the entire system of preparation and training of personnel. In the training field of new personnel it continued the application of a combination method. In this way it continued the application of accelerated training forms with the regular ones, with a tilt of the balance by the latter. The selection of the personnel was based on the class criterion and it remained a constant policy. Priority was given to the attraction in the whole pedagogical-education system of elements that originated from a poor background from the countryside and the working class. Something, that led to important changes in the social composition of the teaching personnel.

The relative strengthening of the education-teaching system created more spaces that led to important quantitative developments. The largest recruitments according to data from the academic year 1965-1966 were observed in the upper classes of the 8-year school. While the needs for sufficient personnel in the primary education were fulfilled. Relative developments on a national level were also observed as an increase on the number of high school teachers. A smaller amount of changes was observed in the field of training, which for a long period remained a "weak point" for the whole pedagogical-education system.

The analysis of the documentation of this particular period from 1960 to 1965 leads to the conclusion that the process of training and the qualification of the new teaching personnel was done in a constrained manner. The methods employed were not appropriate in two aspects that of the general culture training as well as that professional and methodical training. Consequently, although there were considerable quantitative changes in relation to the beginning of this period, the entire system and especially that of training, failed to become consolidated sufficiently. As result these lead to an undoubtful effect in the quality level of the Albanian school of this period.